




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



V E N D I M

Nr. 952, datë 12.12.2012

PËR

**PËRJASHTIMIN E PROFESIONISTIT NGA DETYRIMI
PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË SHTETIT PËR PROFESIONET
E RREGULLUARA**

Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfashtimin nga detyrimi për dhënie e provimit të shtetit të profesionistit, i cili ka fituar të drejtën e ushtrimit të njërit prej profesioneve të rregulluara, të parashikuara në nenin 5, të ligjit nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose ka përfunduar me sukses provimin e shtetit, në një nga vendet e mëposhtme:
 - a) Vendet anëtare të Bashkimit Europian;
 - b) Vendet e EFTA-s (Shoqata Europiane për Tregtinë e Lirë): Zvicër, Lihtenshtein, Norvegji, Islandë;
 - c) Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim;
 - ç) Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
 - d) Kanada;
 - dh) Japoni.

2. Profesionisti, që përfiton nga përcaktimi i pikës 1, të këtij vendimi, duhet të ketë përfunduar arsimin universitar përkatës, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë.
3. Profesionisti aplikon për regjistrim për ushtrim të profesionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë pranë urdhrave profesionalë përkatës dhe, në mungesë të tyre, pranë autoritetit kompetent. Pas shqyrtimit të aplikimit, kur plotësohen kriteret e pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, urdhri profesional përkatës ose, në mungesë të tij, autoriteti kompetent, kryen regjistrimin e profesionistit.
4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe autoritetet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I




A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to read 'Berisha', is written over a horizontal line.

SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAJAJ



A handwritten signature in black ink, which appears to read 'Myqerem Tajaj', is written over a horizontal line.